



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 154/10 prot.

Tiranë, më 06.09.2022

VENDIM
Nr. 112 , datë 06.09.2022

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 55, DATË 19.04.2022

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 55, datë 19.04.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të procedurës administrative për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin *****”,

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar kërkesa me nr.154 prot., datë09.02.2022, e paraqitur nga nënpunësi ***** , me detyrë “Përgjegjës në Sektorin e Planifikimi të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, në Bashkinë Vlorë, përmes së cilës ngrihen pretendime për pezullim të marrëdhënies në shërbimin civil, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit civil.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrative mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin paralajmërues nr. 55, datë 19.04.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të procedurës administrative për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin *****”.

Bazuar në detyrat e lëna për Bashkinë Vlorë në përmbajtjen e vendimit e paralajmërues, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situta e administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1, Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Bashkia Vlorë, të konstatojë përfundimin e shkakut të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të cituar në akt-pezullimin nr. 281, datë 15.11.2011, (15151 prot., datë 15.11.2021), “Për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil të Bashkisë Vlorë”, të dhënë për punonjësin ******, me detyrë “Përgjegjës, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, duke e rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.

Konstatohet se, në njësia përgjegjëse e këtij institucioni nëpërmjet shkresës nr. 4276/2 Prot., datë 18.07.2022, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 154/7 datë 25.07.2022, “Mbi zbatimin e Vendimit nr.55, datë 19.04.2022”, bën me dije se Bashkia Vlorë ka nxjerrë shkresën “Akt-Përfundim Pezullimi” me nr. 57, datë 13.07.2022, me anë të së cilës është vendosur përfundimi i shkakut të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil dhe kthimin në detyrën “Përgjegjës” në Drejtorinë e Urbanistikës, të nëpunësit ******.

Për sa u përket më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit, Bashkia Vlorë, janë zbatuar detyrat e lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.55, datë 19.04.2022, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të procedurës administrative për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin ******” të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 55, datë 19.04.2022., të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të procedurës administrative për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin ******”.
2. Kthimin e gjendjes së ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga ana e institucionit Bashkia Vlorë, në përputhje me detyrat e lëna në diapozitivin e Vendimit nr.55, datë 19.04.2022.

3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Vlorë dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha